



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Në ankesën e

AC-I-22-0666-A0001

Paditësja/Ankuesja

L P, Gjilan.

kundër

E paditura

NSH "Morava e Binqës" (në likuidim), përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, Rr. "Dritan Hoxha" nr.55, Lakrishtë, Prishtinë

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani gjyqtar kryesues, Shkelzen Sylaj dhe Bajram Miftari, gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditëses të paraqitur kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-13-2232 të datës 17 nëntor 2022, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 21 mars 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- 1. Ankesa e paditëses është e bazuar.**
- 2. Ndryshohet Aktgjykimi i Shkallës së I-rë I DHPGJS-së, C-IV-13-2232 i datës 17 nëntor 2022, dhe Vendimi i AKP-së-Autoritetit të Likuidimit GJI037-1139, i datës 06 shtator 2013.**
- 3. Obligohet AKP-ja ti paguaj paditëses në emër të kompensimit për ndërprerje të parakohshme të Kontratës së punës në NSH "Morava e Binqës" (në likuidim), shumën prej 1,707.16 euro, sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurën e Likuidimit.**
- 4. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

Rrethanat procedurale dhe faktike

Me 08 tetor 2013, paditësja dorëzoi në Dhomën e Posaçme, një ankesë kundër vendimit të Autoritetit të likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit nr.GJI037-1139, të datës 06 shtator 2013 (më tej AL), me të cilin AL, kishte refuzuar kërkesën e paditëses për kompensim për ndërprerje të parakohshme të Kontratës së punës në shumë prej 1,707.16 euro me arsyetimin se paditësja në kohën e privatizimit të NSH "Morava e Binqës", nuk ka qenë punëtore aktive e NSH-së, dhe nuk figuron në listën e pagave për muajt prill-korrik 2010, andaj nuk i plotëson kushtet ligjore nga neni 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së. Paditësja pohoi se kërkesa e saj është e bazuar në Ligjin mbi marrëdhëniet e Detyrimeve, Statusin e NSH, Rregulloren e UNMIKU-ut dhe Ligjin e Punës të Republikës së Kosovës. Thekson se AL dhe NSH me refuzimin e kërkesës kanë bërë shkelje të rëndë të ligjeve të lartcekura. Ngase të gjitha këto ligje e parashohin dhe e precizojnë pagesën e pagave me prioritet në mënyrë lineare, nëse i ndërpritet marrëdhënia e punës pa fajin dhe dëshirën e saj. Tutje ka shtuara se ka prova bindëse materiale që asaj i është ndërpre marrëdhënia e punës ne NSH si rezultat i privatizimit, meqë ajo nëpërmes letre pezullimit me shkrim të dt. 09 gusht 2010, AKP e kishte njoftuara se punësimi i saj ndërpritet për shka të privatizimit të NSH-së "Morava e Binqës". Në mbështetje të ankesës si provë ka bashkangjitur dokumentet në kopje si: vendimin e kundërshtuar të AL-së si dhe letër pezullimin e datës 09 gusht 2010.

Më 27 gusht 2018, AKP-ja parashtroi mbrojtje në ankesë, në të cilën pohon se i kundërshton të gjitha pretendimet e paditëses, duke i konsideruar si të pa bazuar në ligj dhe si të tilla duhet të refuzohen. E paditura pohoi se paditesaj nuk ka prezantuar fakte në kuptim të nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore ku theksohet se " Palët kanë detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen fakte të tilla". AKP-ja thekso se e mbështet konstatimin e AL. Më tej e paditura pohoi se e konsideron se pretendimet e paraqitura në ankesë, nuk janë të mbështetura me dëshmi dhe fakte materiale që do të ishin relevante për rastin konkret. AKP-ja propozoi që ankesa të refuzohet si e pa bazuar.

Me 17 nëntor 2022, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së, me Aktgjykimin C-IV-13-2232, ankesën e paditëses e ka refuzuar si të pa bazuar dhe ka vërtetuar vendimin e Autoritetit të Likuidimit GJI037-1139 i datës 06 shtator 2013, si i drejtë dhe i bazuar në ligj. Në arsyetim të vendimit thuhet se në bazë të nenit 42 pika 2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtresat apo duke paraqitur provat materiale të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese), ndërsa pika 3 parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë. Shkalla e I-rë ka konstatuar se paditësja nuk kishte parashtruar prova relevante në procedurën e likuidimit pranë AL-së për të mbështetur besueshmërinë e kërkesës së tij. Po ashtu shkalla e I-rë ka konstatuar se paditësja nuk ka ofruar ndonjë dëshmi relevante as në kohën e parashtrimit të ankesës në gjykatë, me të cilat do të mund të dëshmonte faktin se është pushuar nga puna si rrjedhojë e vendimit për likuidim të ndërmarjes apo në lidhje me veprimin e ndërmarre nga AKP. Paditësja nuk ka ofruar ndonjë dëshmi relevante në gjykatë për të mbështetur pretendimin e saj lidhur me kërkesën për dëmshpërblim, dëshmi me të cilat do të mund të dëshmonte faktin se ka ofruar shërbime/punë për NSH-në dhe se NSH-ja detyrohet për kompensimin e dëmshpërblimit.

Me 12 dhjetor 2022, paditësja/ankuesja e dorëzon në DHPGJS një ankesë të afatshme kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS C-IV-13-2232 të datës 17 nëntor 2022, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, zbatimit të gabuara të ligjit nr.06/L-086 të DHPGJS dhe shtojcës së Ligjit të AKP-së. Paditësja kërkon nga Kolegji i Apelit që të aprovohet ankesa e saj si e bazuar, të anulohet Aktgjykimi i ankimuar dhe ta ndryshojë vendimin e ankimuar në kuptim të aprovimit të kërkesave të ankueses për tu kompensuar në shumën dhe nga baza si në padi, për shkak të ndërprerjes së parakohshme të kontratës së punës. Ankuesja konsideron se një përfundim i tillë i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës bie ndesh me Ligjin për Dhomën e Posaçme me dispozitat e Ligjit për AKP-në dhe

me dispozitat janë zbatuar në mënyrë të gabuar, ndërsa e gjithë kjo ka reflektuar në vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje ligjore.

Paditësja/ankuesja konsideron se nuk qëndron arsyeja që është dhënë në aktgjykimin e ankimuar, se paditësja nuk ka ofruar fakte dhe prova të mjaftueshme për ti arsyetuar kërkesat e pretenduar në padi, ngase paditësja fillimisht te Autoriteti i Likuidimit dhe më pasatja ka bashkangjitur padisë edhe gjykatës i ka ofruar informatat fakte dhe dokumentacion të mjaftueshëm konform nenit 7 të Ligjit për Procedurën Konstestimore, për ta vërtetuar besueshmërinë juridike të kërkesave të saj, mirëpo si rrjedhojë e vlerësimit të gabuar të provave, gjykata e shkallës së I-rë, marrë vendimi të tërësishëm në dëm të paditëses. Ka shtuar se ajo ka qenë punonjëse aktive në Ndërmarrjen shoqërore "Morava e Binqës", deri më datë 09 gusht 2010, kur për shkak të privatizimit të ndërmarrjes, me Letër Pezullimin e Agjencionit Kosovare të privatizimit asaj i komentohet, se punësimi i saj në këtë ndërmarrje përfundon menjëherë.

E pa kënaqur me ndërprerjen e kontratës, në afatin e paraparë ligjorë paditësja i është adresuar me kërkesë Autoritetit të Likuidimit të AKP-së për ti realizuar të drejtat e saja për kompensim nga ndërmarrja, pagesën e pagave të bazuara në përvojën e punës për shkak të ndërprerjes së parakohshme, mirëpo përkundër plotësimit të kriterëve ligjore të parapara me ligjin për Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe shtojcës së këtij ligji, Autoriteti i Likuidimit me Vendimet nr.GJIO-1139, sikur edhe gjykata me aktvendimin e ankimuar, në mungesë të vlerësimit të drejtë të provave dhe në kundërshtim me këto fakte ligjore, kërkesën a paditëses e ka refuzuar pa ndonjë arsyetim të veçante.

Në bazë të nenit 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit për AKP-në përcakton citojmë: "Punëtorëve u takon e drejta e dëmshpërblimit për ndërprerjen e parakohshme të kontratës së punës, nëse të njëjtit pushohen nga puna si rrjedhojë e vendimit për likuidimin e ndërmarrjes". Në rastin konkret, paditëses i ishte ndërprerë kontrata e punës pikërisht për arsyet e vendimit të marrë për likuidimin e ndërmarrjes shoqërore "Morava e Binqës" në të cilën paditësja ka pranuar, prandaj në rastin e saj dispozitat e mësipërme nga gjykata është zbatuar në mënyrë të gabuar. Duke marrë parasysh këto arsye paditësja konsideron se si ka mundësi që Shkalla e I-ë e DHPGJSK-së ka ardhë në

përfundim se paditësja nuk ka ofruar dëshmi të mjaftueshme për të arsyetuar faktin se është pushuar nga puna si rrjedhojë e vendimit për likuidim e ndërmarrjes, kur padisë së ushtruar ia ka bashkangjitur Letër pezullimin e datës 09 gusht 2010, paragrafi 3. I të cilës ka parashikuar, citojmë:” Shumat-pagat që u janë borxh juve sipas kontratës suaj të punësimit të punëdhënësit do të mbesin përgjegjësi e punëdhënësit dhe kërkesat e tilla do të shqyrtohen sipas proceduarve të likuidimit dhe ju do të kontaktoheni kur të fillojnë këto proceduara”. Paditësja me një punë dhe me një përvojë mbi 30 vjeçare në Ndërmarrjen Shoqërore në likuidim” Morva e Binqës” në Gjilan nuk ka dhënë ndonjë shkas apo arsye që ti ndërpritet kontrata e punës. Ajo nuk ka dhënë pëlqim për ndërprerjen të kontratës, por se ky veprim është bërë njëanshëm dhe në mënyrë të dhunshme nga Agjencia Kosovare e Privatizimit. Ka shtuar se ajo e konfirmon se punonjësit e tjerë të kësaj ndërmarrje duke qenë nën kushtet e njëjta si ajo, tashmë që qe kanë realizuar kompensimin adekuat nga baza e ndërprerjes së parakohshme të kontratës së punës, ndërsa e njëjta jo, përkundër faktit së evidencës nga librat amë të NSH’ ‘Morava e Binqës’.

Paditësja në ankesë e parashtruar ka propozuar që të evitohet kundërligjshmëria e aktgjyqimit të atakuar dhe të vendose ligjshmëria në këtë çështje, duke u vërtetuar si të bazuar kërkesat e parashtruara në petitumin e padisë.

Me 22 dhjetor 2023, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS-ë një parashtresë dhe i përgjigjet ankesës së paditëses /ankueses, duke propozuar që të refuzohet a ankesa e ankueses si e pa bazuar dhe të vërtetohet aktgjykimi i atakuar. E paditura thekson se lidhur me argumentet e ankesës është qartësisht dhe mjaftueshërisht i sqaruar në Mbrojtjen e parashtruar si dhe në Aktgjykimin me Nr.C-IV.-13-2232 të DHPGJS-së, pranë shkallës së I-re Përsëritja e tyre argumenteve të cilat janë parashtruar më parë do të ishte e padobishme për mbarëvajtjen e procedurës, për këtë arsye andaj pala kundërshtarë i parashtron Kolegjit të Ankesave që t’i referohet Mbrojtjes dhe Aktgjyqimit përkatës.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa e paditëses është e bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, nuk është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj duhet ndryshuar dhe të aprovohet padia si e bazuar.

Në bazë të nenit 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së parashihet që "kërkesat për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës të sjella nga punonjësit të cilat janë pushuar nga puna si rrjedhojë e Vendimit për Likuidim të ndërmarrjes, apo në lidhje me veprimin e ndërmarrë nga Agjencia sipas nenit 6.1 apo 6.2 të Ligjit për AKP-në". Kjo dispozitë ligjor e parashikon dëmshpërblim për ndërprerje të marrëdhënies së punës, nëse kjo ndërprerje është rezultat i veprimit të AKP-së të ndërmarrë në suaza të autorizimeve ligjore të përcaktuar për AKP-në në bazë të nenit 6.1 apo 6.2 të Ligjit të AKP-së.

Në këtë lëndë është e qartë se AKP-ja e i ka dërguar paditëses Njoftimin për përfundimin e punësimit si rezultat i shitjes së NSH-së " Morva e Binqës" në Gjilan i cili mban dt. 09 gusht 2010, në të cilën shprehimisht ceket se shumat-pagat që u janë mbetur borxh juve sipas kontratës tuaj do të mbesin përgjegjësi e punëdhënësit dhe se këto do të shqyrton ne procedurë të Likuidimit kur të filloj procedura. Me këtë Njoftim është e qartë se paditëses i është ndërprerë marrëdhënia e punës me datë 09 gusht 2010, si rezultat i shitjes se NSH-së.

Ky veprim i AKP-së është i qartë se është ndërmarrë brenda fushëveprimit të përcaktuar nga neni 6.2 nën paragrafi 2.2 të Ligjit mbi AKP-në, që përcakton autorizimin e AKP-së të filloj procedurat e likuidimit ndaj NSH-ve, mbi të cilat ajo e shtrinë autoritetin administrativ.

Autoriteti i Likuidimit dhe Shkalla e I-rë e DHPGJS-së kërkesën e paditëses për kompensim për ndërprerje të parakohshme të Kontratës së punës në shumë prej 1,707.16 euro, e kanë refuzuar me arsyetimin se paditësja nuk ka qenë në Listën e punëtorëve aktiv të ndërmarrjes në kohën e fillimit të procedurës së likuidimit.

Kolegji i Apelit konstaton se nuk ka qenë aspak relevant fakti se a ka qenë apo jo paditësja në Listën e punëtorëve aktiv të ndërmarrjes të hartuar nga menagjmenti i NSH-së, në kohën e fillimit të procedurave të likuidimit të NSH-së, pasi që kjo listë nuk është e qartë se në çfarë baze ligjore apo kriteri është hartuar.

Për më tepër është shumë e qartë se AKP-ja si përfaqësuese e NSH-së ka dështuar të dorëzoi në gjykatë ndonjë dëshmi se paditësja më herët me ndonjë vendim i është ndërprerë marrëdhënia e punës nga ana e NSH-së. Nëse dëshmi të tilla ka patër AKP-ja, ajo ka mundë të dërgoi në gjykatë, për të mbështetur pretendimin e saj se paditësja nuk ka qenë punëtore aktive e NSH-së dhe ajo nuk ka punuar për NSH-në në kohën e fillimit të procedurave të Likuidimit ndaj NSH-së. Barra e provës për të vërtetuar këtë fakte i bie të paditurës. Nëse paditësja nuk ka punuar për NSH-në në kohën e fillimit të procedurave të likuidimit, siç pretendon AKP-ja, atëherë nuk ka pas arsye dhe as nevojë ti dërgohej paditëses Njoftimi për anulimin e Kontratës së saj të punës.

Paditësja me provat që i ka sjellë në Shkallën e I-rë të DHPGJS mjaftueshëm ka provuar faktin se asaj i është ndërprerë Kontrata e punës në NSH për shkak të shitjes së NSH-së. Andaj për shkak të këtij veprimi të AKP-së ajo ka pësuar dëme dhe në bazë të nenit 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, ajo ka të drejtë në kompensim për shkak ndërprerjes së parakohshme të Kontratës së punës.

Paditësja në ankesën e saj ka kërkuar shumën prej 1,707.16 euro në emër kompensimit për shkak ndërprerjes së parakohshme të Kontratës së punës. Me ankesën në shkallën e dytë prapë e kërkon shumën prej 1,707.16 euro.

Kolegji i Apelit vëren se lartësia e kompensimit në shumë prej 1,707.16 euro e cila ishte paraqit tek Autoriteti i Likuidimit nuk është kontestuar shprehimisht nga AKP-ja në mbrojtjen në ankesë të dhënë në procedurën e Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, dhe në kundërpërgjigje. Prandaj ky fakt i pa kontestuar nga Kolegji i Apelit konsiderohet si fakt i provuar.

Andaj nga këto arsye, Kolegji i Apelit e aprovon ankesën e paditëses si të bazuar, e ndryshon Aktgjykimin e ankimuar të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së dhe Vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit, dhe e aprovon si të bazuar padinë lidhur me dëmshpërblimin për shkak të ndërprerjes së kontratës së punës.

Nga këto arsye, e në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, është vendosur sikurse në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Taksat gjyqësore

Ankuesja tashmë e ka paguar taksën gjyqësore me datë 29 dhjetor 2022 për procedurën ankimore para Kolegjit të Apelit, andaj nuk ngarkohet me takes shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 21 mars 2024.

Mr.Sc Sahit Sylejmani, Gjyqtar kryesues
